REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr 7398 Prot

Lushnje, më 28 / 08 /2025

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK
Këtu

"PËR EMËRTIMIN "SHKOLLA E BASHKUAR FIERSHEGAN"

Në vijim të kërkesës për bashkimin e shkollave 9-Vjeçare Fiershegan dhe Gjimnazit Fiershegan dërguar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, nga ZVAP Lushnjë dhe Bashkia Lushnjë, MAS kërkon të njihet me vendimin e Këshillit Bashkiak për miratimin e emërtimit të shkollës së bashkuar, për të vijuar me procedurën për bashkimin e 2 (dy) institucioneve arsimore parauniveristare publike në formën e shkollës së bashkuar.

Në vijim të konsultimit publik i realizuar në *datën 29.05.2025*, me banorët e zones,drejtuesit dhe mësuesit e shkollave dhe grupeve të interest, informacion i dërguar në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar me shkresën e dërguar nga Qendres së Arsimit me nr 327 prot. Datë 09.06.2025 dhe në zbatim të shkronjës "II", të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, *Këshilli Bashkiak vendos për emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë* dhe Vendimit nr. 662, datë 8.10.2014, Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike", të ndryshuar, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit do të përcillet edhe vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e emërtimit të shkollës së bashkuar.

Duke ju falënderuar!

KRYETAR I BASHKISË

Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA LUSHNJE

Nr 7398/1 Prot.

Lushnje, më 28 / 08 /2025

PROJEKT- VENDIM

NR. 80 DATË 28 / 08 /2025

" PËR EMËRTIMIN " SHKOLLA E BASHKUAR FIERSHEGAN"

Këshillit Bashkiak në mbledhjen e datës___/___/2025 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur,në mbështetje të nenit 8 pika 2,nenit 9,pika 1.7,shkronja"b"nenit 54 shkronja"ll"të Ligjit nr.139/2015,"Për vetqeverisjen vendore",i ndryshuar.Vendimi I Këshillit të Ministrave nr.662,datë 08.10.2014 "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike" të ndryshuar JU:

PROPOZOJMË

1. Miratimin e emërtimit për shkollën në Fiershegan **"Shkolla e Bashkuar Fiershegan".**
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Qendra e Arsimit Bashkia Lushnje.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

DREJTORIA JURIDIKE

Bedri Hida

QENDRA E ARSIMIT

Muharrem Sharka

KRYETARI I BASHKISË

Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPERISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222439 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com